

VENDIM
Nr. 226, datë 13.4.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 317, DATË 15.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, PËR PËRDORIMIN E QËNDRUESHËM TË PRODUKTEVE, PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE KRITERET E KUALIFIKIMIT PËR PËRDORUESIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 23, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 317, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) kudo në tekst, emërtimi “Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve” zëvendësohet me “Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)”;

b) në pikën 3, të kreut I, pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j”, me këtë përmbajtje:

“j. “Prodhues” është subjekti i regjistruar në regjistrin e fermës dhe që ushtron aktivitet bujqësor, si:

- i. fermer që është pajisur me kod fermeri dhe/ose NIPT fermeri;
- ii. person fizik i pajisur me numër identifikimi për personin e tatueshëm nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- iii. person juridik i pajisur me numër identifikimi për personin e tatueshëm nga Qendra Kombëtare e Biznesit.”;

c) pika 10, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Prodhuesi mban dhe plotëson regjistrin e përdorimit të PMB-ve në fermë. Fermerët dhe individët, që kultivojnë për konsum familjar, e mbajnë regjistrin në mënyrë vullnetare. Modeli i regjistrit, përmbajtja dhe plotësimi i tij miratohen me urdhër të ministrit.

Regjistri i vihet në dispozicion Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve gjatë kontroleve zyrtare të kryera në fermë ose sa herë kërkohet. Regjistri, gjithashtu, mund t’i vihet në dispozicion palëve të treta që kanë detyra të certifikimit të fermave ose prodhimeve të lidhura me etiketat e cilësisë, si dhe pikave të grumbullimit dhe përpunimit, nëse kërkohet.”.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama